



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 49 (827904)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 13 dhjetor 2024

Të mbrojmë dinjitetin njerëzor të grave: “Dëgjomë dhe mua!”



» faqe 3



Marrëveshja me Slloveninë, forcim i kapaciteteve në përballimin e emergjencave natyrore

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu prezantoi në Kuvendin e Shqipërisë, ratifikimin e marrëveshjes mes qeverisë së Sllovenisë dhe Shqipërisë për bashkëpunimin në mbrojtjen ndaj katastrofave natyrore. Kjo marrëveshje vjen në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare për forcimin e Mbrojtjes Civile në kuadër të NATO-s dhe mekanizimin evropian të Mbrojtjes Civile.

“Qëllimi i marrëveshjes është që të rregullojë ofrimin e ndihmës së ndërsjellë në rast katastrofash natyrore apo emergjenca të tjera dhe të nxisë bashkëpunimin në fusha kyçe si aftësimi i personelit të transferimit të njohurive dhe zhvillimi i teknologjive për Mbrojtjen Civile. Sllovenia është një vend me kapacitete shumë të konsoliduara për Mbrojtjen Civile, model për sa i përket rrjetëzimit të vullnetarëve në të gjithë territorin e vendit për të përballuar fatkeqësitë natyrore, por sa i përket edhe bashkërendimit mes pushtetit vendor dhe atij qendror për Mbrojtjen Civile. Kjo marrëveshje vjen si shkëmbim eksperiencash, por që i gjithë mekanizimi slloven i Mbrojtjes Civile të mund të vijë në ndihmë në rast nevojë në vendin tonë dhe anasjelltas. Forcat e Armatosura të vendit tonë dhe Emergjencat Civile kanë kohë që operojnë edhe në vende të tjera jashtë Shqipërisë, së fundmi në Turqi dhe në Greqi”, - tha ai.

Ministri Vengu foli edhe për efektin e dytë të rëndësishëm që ka kjo marrëveshje me Slloveninë në aspektin e ndërtimit të një rrjeti



“QËLLIMI I MARRËVESHJES ËSHTË QË TË RREGULLOJË OFRIMIN E NDIHMËS SË NDËRSJELLË NË RAST KATASTROFASH NATYRORE APO EMERGJENCA TË TJERA DHE TË NXISË BASHKËPUNIMIN NË FUSHA KYÇE SI AFTËSIMI I PERSONELIT TË TRANSFERIMIT TË NJOHURIVE DHE ZHVILLIMI I TEKNOLOGJIVE PËR MBROJTJEN CIVILE. SLLOVENIA ËSHTË NJË VEND ME KAPACITETE SHUMË TË KONSOLIDUARA PËR MBROJTJEN CIVILE, MODEL PËR SA I PËRKET RRJETËZIMIT TË VULLNETARËVE NË TË GJITHË TERRITORIN E VENDIT PËR TË PËRBALLUAR FATKEQËSITË NATYRORE, POR SA I PËRKET EDHE BASHKËRENDIMIT MES PUSHTETIT VENDOR DHE ATIJ QENDROR PËR MBROJTJEN CIVILE”.

vullnetarësh në Shqipëri në rast fatkeqësish natyrore të të gjitha llojeve.

“Efekti i dytë ka të bëjë me fitimin e eksperiencave të mëtejshme sa i përket dedikimit

që pushteti vendor i jep Mbrojtjes Civile dhe ndërtimi i një rrjeti vullnetarësh në vendin tonë. Ne e shohim që reaguesit e parë janë qytetarët, sa herë që ka një vatër zjarri, një përmbytje

dhe ne na duhet të krijojmë mekanizma për të stërvitur pushtetin vendor dhe agjencitë që operojnë në terren.

Efektet financiare të kësaj marrëveshje nuk janë të përlllogaritura saktësisht, por ajo që parashikohet është fakti se shërbimet e Mbrojtjes Civile shqiptare nëse u vijnë në ndihmë atyre sllovene dhe anasjelltas do të përballohen dhe konfigurohen brenda mekanizmit evropian të Mbrojtjes Civile”, - ministri Vengu.

Ministri theksoi se “kjo marrëveshje përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të forcuar kapacitetet tona kombëtare dhe menaxhim ndërkombëtar në përballimin e emergjencave. Është një dëshmi e përkushtimit që kemi për të mbrojtur qytetarët dhe për të kontribuar në sigurinë kombëtare. Kjo nuk është marrëveshja e parë, është e treta që kemi bërë pas Kosovës dhe Maqedonisë dhe do të pasohet nga marrëveshje të tjera, me Greqinë dhe Italinë si vende kyçe në përballimin e emergjencave civile”.



Të mbrojmë dinjitetin njerëzor të grave: “Dëgjomë dhe mua!”

Në kuadër të fushatës 16 ditore në bashkëpunim me OKB-në, kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, me moton: “Asnjë Justifikim: Bashkë kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave”.

Ky aksion mbarë botëror bëri bashkë institucione, organizata dhe qytetarë në aktivitete që synojnë ndërgjegjësimin dhe dhënien fund të dhunës me bazë gjinore. Secili prej nesh mund të bëjë ndryshimin. Pjesë e kësaj fushate u bënë vajzat dhe gratë e Forcave të Armatosura, të cilat sollën mesazhet e tyre sensibilizuese ndaj këtij diskriminimi gjinor.

Shqipëria vlerësohet të ketë përparime në legjislacionin e saj kundër dhunës në familje dhe ndaj grave, por ende ka çështje të cilat kërkojnë të zgjidhen me urgjencë. Në këtë përfundim ka arritur raporti i ri i publikuar nga GREVIO (Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje), i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën ndaj dhunës mbi gratë dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit. Shqipëria e ratifikoi këtë konventë në vitin 2013, dhe raporti i parë për situatën në vend, ka qenë në vitin 2017. Që prej asaj kohe, vendi vlerësohet të ketë ndërmarrë “ndryshime ligjore gjithëpërfshirëse”, përfshirë “Ligjin për Masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe Kodin Penal, si dhe miratimin e akteve të shumta nënligjore, udhëzimeve të përgjithshme dhe manualeve. Sipas GREVIO-s, ndërhyrjet e tjera ligjore që po ndërmerren, janë dëshmi e



“përkushtimit të autoriteteve në ndërtimin e një kuadri ligjor të fortë dhe të qëndrueshëm për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje”.

Të dhënat e fundit të Institutit të Statistikave, të cilat i përkasin vitit 2022, tregojnë se përgjatë

atij viti, kanë raportuar dhunë në familje 1.371 gra. Bëhet fjalë për numrin e raportimeve të bëra në polici. Qarku që zë peshën më të madhe të grave të dëmtuara nga dhuna në familje është ai i Tiranës, i ndjekur nga qarku i Durrësit dhe Vlorës. Përkatesisht 34,1 % ndaj totalit të grave

të dëmtuara i përkasin qarkut të Tiranës, 19,9 % Durrësit dhe 9,1 % Vlorës.

Në vitin 2022, nga 42 vrasje të regjistruara me dashje rreth 26,2 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Që prej vitit 2006, kur në Shqipëri hyri në fuqi ligji i parandalimit të dhunës në familje, në të gjitha format e saj, mbi 33 mijë gra janë pajisur me urdhër mbrojtjeje nga gjykatat, ndërsa 611 persona janë arrestuar për dhunë në familje. Gjatë vitit të kaluar, për shkak të dhunës ekstreme, humbën jetën 11 gra, ndërsa, që nga viti 2010, në Shqipëri janë vrarë 159 gra.

Motoja e çdo gruaje: Unë u rrita për të vazhduar përpara, u rrita duke mësuar që të zgjohesha çdo mëngjes dhe të provoja përsëri edhe kur zemra ime është e thyer, për të vazhduar të ec edhe kur gjithçka që dua të bëj është të fshihem, më mësuan të pretendoj se jam në rregull derisa të bëhet realitet, mësova të buzëqesh edhe kur zemra ime është e trishtuar, të flas kur të gjitha fjalët duken të kota, të qep plagët e mia në heshtje, të rrëzohem por të besoj se është vetëm për pak kohë, për të kapërcyer plagët e mia edhe nëse më dhemb kaq keq, për të miqësuar dhimbjen time derisa të shpërndahet, jeta më ka mësuar se nuk ke zgjidhje tjetër veçse të mbijetosh...



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, i shoqëruar nga një delegacion i FA-së, zhvilloi një vizitë zyrtare në Ankara, Turqi, me ftesë të homologut të tij, gjeneral Metin Gürak.

Gjatë vizitës në Ankara, gjenerallejtënant Kingji, fillimisht vendosi kurorë në Memorialin Mauzole, në nderim të themeluesit të Republikës së Turqisë, Mustafa Kemal Atatürk. Më pas, gjenerallejtënant Kingji u prit me nderimet më të larta ushtarake dhe zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneral Metin Gürak.

Në takimin me homologun e tij, gjenerallejtënant Kingji theksoi rolin e Turqisë si partner i rëndësishëm strategjik i Shqipërisë, e reflektuar tek marrëdhënia e shkëlqyer e bashkëpunimit, më veçanërisht në fushën e Mbrojtjes. Ai shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe kontributin e Forcave të Armatosura të Turqisë në procesin e reformimit, transformimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura, që nga mbështetja logjistike, zhvillimin e kapaciteteve operacionale, arsimim, trajnim dhe mbështetjen me instruktorë të forcave tona komando, në angazhimet e përbashkëta në operacione dhe stërvitje të ndryshme si në kuadër të NATO-s dhe dypalëshe, mbështetjen gjatë emergjencave civile, si dhe në mbështetjen për trajtimet shëndetësore të personelit të FARSH-së.

Gjeneral Gürak nga ana e tij e falënderoi gjenerallejtënant Kingjin për vizitën si dhe vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh, duke siguruar se Forcat e Armatosura të Turqisë do të vazhdojnë mbështetjen në fushën e trajnimit dhe arsimimit ushtarak, stërvitjes, modernizimit dhe fusha të tjera me interes të përbashkët.

Nisur nga paqëndrueshmëria e mjedisit të sigurisë, gjeneral Gürak theksoi rolin konstruktiv të vendit tonë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, kontributin e FARSH-ve në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, dhe qëndrimin e palës turke se një Shqipëri e fortë është kontributi më i mirë për një rajon të sigurt.

Në kuadër të stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal, ai vlerësoi rolin konstruktiv të Shqipërisë në mbështetjen e iniciativave rajonale, duke



SHSHPFPA, gjenerallejtënant Arben Kingji, vizitë zyrtare në Turqi

theksuar Forumin e Shefave të Shtabit të Ballkanit, që pritet të zhvillohet në Ankara, në vitin 2025. Në vijim të takimit dypalësh,

gjenerallejtënant Kingji dhe delegacioni shoqëruar u njohën me strukturën organizative dhe zhvillimet më të fundit të Forcave të

Armatosura të Turqisë.

Pas zhvillimit të takimeve në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së të Turqisë, gjenerallejtënant Kingji u prit në takim nga ministri i Mbrojtjes së Turqisë, z. Yaşar Güler.

Gjenerallejtënant Kingji falënderoi ministrin Güler për mikpritjen e ngrohtë dhe vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer në fushën e Mbrojtjes ndërmjet vendeve tona.

Takimi u fokusua kryesisht në raportin e ngushtë të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes mes dy vendeve tona dhe situatës së sigurisë në rajon dhe më gjerë, ku me këtë rast, gjenerallejtënant Kingji vlerësoi rolin e Turqisë për stabilitetin e rajonit dhe rolin aktiv të Turqisë në mbështetje të operacionit KFOR në Kosovë.

Ministri Güler nënvizoi gjithashtu nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve mes dy vendeve tona dhe gatishmërinë e palës turke, për gjetjen e potencialeve të reja të bashkëpunimit ushtarak.



Helikopteri AS532AL “Cougar” 632, në gatishmëri të plotë

Helikopteri tip AS532AL “Cougar” me numër FA632 mbërriti në Aeroportin e Rinasit dhe është në gatishmëri të plotë operacionale.

Ky helikopter shumë-funksional është një mjet i rëndësishëm për kryerjen e operacioneve të ndryshme ushtarake dhe civile. Pas përfundimit të punimeve të mirëmbajtjes pranë kompanisë RUAG në Zvicër, dhe falë bashkëpunimit me NSPA (Agjencinë e Prokurimeve të NATO-s), po rikthehet progresivisht gatishmëria teknike e mjeteve në Forcën Ajrore.

Fluturimi i kontrollit teknik dhe i marrjes në dorëzim (Acceptance Test Flight) është kryer nga personeli pilot dhe teknik të Forcës Ajrore shqiptare në bord.





Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, vizitë zyrtare në Rumani

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra realizoi një vizitë zyrtare në Rumani me ftesë të autoriteteve homologe rumune.

Gjatë vizitës zhvilloi takime me drejtues të lartë të Forcave të Armatosura dhe Marinës rumune, duke diskutuar mbi forcimin e bashkëpunimit në kuadër të NATO-s, sigurinë detare dhe zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta. Në Bukuresht, kundëradmiral Agastra u prit nga gjeneral Gheorgiūā Vlad, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Rumanisë dhe admiral Mihai Panait, komandanti i Forcave Detare rumune. Diskutimet u fokusuan në sigurinë detare rajonale, mobiliteti ushtarak dhe arsimimin e personelit të forcave detare. Në kuadër të vizitës, admiral Agastra vizitoi disa institucione të rëndësishme, përfshirë Akademinë e Marinës Rumune, Qendrën e Zhytjes, Shërbimin Hidrografik rumun dhe anije të flotës rumune, si fregata “Regina Maria” dhe anija flamurtare “Mircea”. Kjo vizitë rikonfirmon marrëdhëniet miqësore dhe partneritetin strategjik mes Shqipërisë dhe Rumanisë, duke forcuar angazhimin për sigurinë detare dhe bashkëpunimin në operacionet dhe edukimin detar.



Përfundoi Kursi Bazë i Oficerit



Kursantët e Kursit Bazë të Oficerit përfunduan me sukses fazën e parë të trajnimit, e cila kulmoi me zhvillimin e stërvitjes pesë ditore, që u krye në rajonin stërvitor të Bizës.

Kursi Bazë i Oficerit është një kurs institucional që shërben për marrjen e gradës “Toger”. Ky kurs ka për mision pajisjen e nëntogerëve me njohuri teorike, teknike dhe menaxhuese në të gjitha specialitetet e Forcave të Armatosura, si edhe me aftësitë bazë për komandimin e togës.

Njohuritë teorike të marra gjatë fazës së parë të stërvitjes u konkretizuan nëpërmjet një fushimi pesë ditor, i cili kishte për qëllim që të aftësonte kursantët në ndërthurjen praktike të veprimeve luftarake që kryhen toga brenda spektrit të saj.

Stërvitja plotësoi objektivat e saj dhe nga ana e kursantëve u përvetësuan konceptet praktike për ngritjen e fushimit, elementët e luftimit (mësymës, mbrojtës dhe jo-kovencional), si dhe ato të mbështetjes me shërbime, të cilat u ndërthurën gjatë stërvitjes komplekse.

Në përfundim të fazës së parë studentët fituan aftësinë e të menduarit dhe të vepruarit në rolin e komandantit të togës (për të gjitha specialitetet përkatëse).

Me rastin e 112-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë kursantët e Kursit Bazë të Oficerit u vizituan nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo etj.

Gjatë takimit shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, pasi u njoh nga komandanti i Qendrës Stërvitore, nënkolonel Jorid Alija me kushtet e jetesës në fushim dhe ecurinë e stërvitjes, i uroi kursantëve festën dhe i përgëzoi ata për përkushtimin e treguar gjatë stërvitjes në përvetësimin me sukses të fazës së parë të trajnimit.

Kjo stërvitje u planëzua dhe u udhëhoq nga vetë kursantët, nën drejtimin e instruktorëve të Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore.



Kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, vizitë mësimore në Komandën Mbështetëse



Në kuadër të programit mësimor të Departamentit të Udhëheqjes Ushtarake në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, zhvilluan sot një vizitë mësimore njohëse në ambientet e Komandës Mbështetëse.

Gjatë kësaj vizite kursantët, nëpërmjet një brifingu prezantues u njohën me misionin, strukturën, detyrat kryesore, operacionet e ndryshme EOD, operacionet në mbështetje të emergjencave civile, operacione në ndihmë të komunitetit, kurset e realizuara në Qendrën Stërvitore dhe prioritetet që ka Komanda Mbështetëse. Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i uroi mirëseardhjen kursantëve dhe stafit të Departamentit të Udhëheqjes Ushtarake dhe u shpreh se praktika të tilla mësimore janë shumë të rëndësishme për t’u njohur më nga afër me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shtabit, ndarjen e detyrave, procedurat administrative për hartimin e shkresave, aktivitetet e përditshme që realizojnë Komanda Mbështetëse dhe strukturat e saj vartëse.



“Martini im”



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Adoleshentët, viktima të realitetit social, apo dështim prindërimi?!

Një 14-vjeçar, nxënës i një shkolle nëntëvjeçare në zemër të kryeqytetit, ka mbetur viktimë e një konflikti mes disa të rinjve, të cilët pas debateve mes tyre në rrjetet sociale e kanë lenë të sqaroheshin në një takim mes tyre.

Fatkeqësisht, jo gjithçka ka shkuar sikurse adoleshentët e kishin lënë të sqaroheshin, teksa kanë vënë në përdorim edhe mjetet prerëse, të cilat i kishin marrë me vete, duke vajtur të parapërgatitur për një konflikt që do precipitonte në tragjedi.

Martini 14-vjeçar nuk jeton më. Ai mbylli sytë përjetë nga një goditje me thikë në zemër. Aty, mu pranë rrethimit të shkollës 9-vjeçare “Fan Noli” që ai frekuentonte. Autori i dyshuar, shok shkolle me Martinin u arrestua nën dyshimet për “vrasje me dashje” dhe “mbajtje pa leje të armëve të ftohta”. Një dramë e madhe që ndodh përditë në shkollat shqiptare.

Sherret nisin në bankat e shkollës dhe për fat të keq përfundojnë me ngjarje tragjike jashtë dyerve të tyre. Pas ngjarjes tragjike të Martinit, besoj çdo baba e nënë e ka kaluar nëpër mendjen e tij; po sikur të ishte fëmija im?

Sot, globalizimi po tjetëron njeriun dhe domosdoshmërisht mënyrën e të ndjerit dhe të jetuarit, po shkërmoq vlerat humane. Dhe këtë fillojmë ta besojmë kur në dyert tona troket ‘morti’. Dhe rëndom shprehemi “faleminderit zot nuk është tek unë”.

Çfarë po ndodh në shoqërinë shqiptare?!

Shoqëria e sotme konsumiste, pa norma dhe moral, pa respekt dhe dinjitet, me një mungesë të theksuar socializimi po rrit breza fëmijësh që nuk njohin dashuri për prindërit, gjyshërit, shokun, shoqen dhe kjo sepse prindërit nuk kanë ‘kohë të mjaftueshme’ për t’u marrë me fëmijët e tyre.

Do të ishte shumë e thjeshtë që të gjenim fajtorin, ta përjashtonim dhe jeta do vazhdonte qetë, por nuk kemi një fajtor, janë disa faktorë që bashkohen.

Kjo ngjarje e rëndë na ngarkon me përgjegjësi për mjedisin ku po rrisim dhe edukojmë fëmijët tanë, duke përfshirë shoqërinë, shkollën dhe familjen.

Si shoqëri, kemi një sfidë të madhe përpara: Të frenojmë promovimin e dhunës në rrjetet sociale dhe hapësirën online, si dhe të ndalojmë çdo lloj shfaqje të dhunshme në shoqërinë tonë. Fëmijët meritojnë të orientohen drejt modeleve pozitive të punës, shkollimit dhe arritjeve nëpërmjet tyre.


Realitet 2024

Unë mendoj se shoqëria shqiptare është mësuar me kriminalitetin. Ngjarja është akoma më e dhimbshme, sepse është ulur mosha e kriminalitetit në shoqërinë tonë. Ulja e moshës së veprimtarisë kriminale tregon se adoleshentët janë viktima të realitetit social, pra një shoqëri që është e dhunshme.

Familja shqiptare është në gjendje katastrofike sa i përket marrëdhënieve burrë-grua, duke humbur vigjilencën ndaj fëmijëve të tyre.

Vajtojmë Martinin, engjellin 14-vjeç, sportistin, kampionin me ëndrra djaloshare. Vajtimi ynë duhet të jetë kolektiv, të farkëtuar në pafuqi njerëzore, pafuqi për të ndërtuar shtetin, shoqërinë, pafuqi për të ndërtuar njeriun. Kjo është klithma e një populli që vuan. Jeta e tyre nga dje në vijim është goditur.

Nuk është rasti i parë, është i disa-ti në vitet e fundit. Kanë qenë jo pak raste, raste edhe të fëmijëve të tjerë që janë vrarë. Pranë



shkollave apo pranë shtëpisë së tyre. Si rrjedhojë e një sherri banal. Nuk dua ta lë tragjedinë brenda një sherri banal.

Tragjedia është pafuqi, mungesë

Prindërit shpenzojnë shumë më tepër kohë në punë. Përlësisht ju kërkoj, kaloni kohë me fëmijët tuaj, edhe sikur të jetoni me më pak të mira materiale, edhe sikur t’ju leni fëmijëve mangët diçka, jepnin kohën tuaj, është e paçmuar prezenca juaj në jetën e tyre. Nuk ka gjë më të madhe se sa prania e babait dhe nënës.

Një telefon në dorë shndërrohet në bomba me sahat nëse nuk kontrollohet. Nuk është trup që babai dhe nëna të monitorojnë

telefonin e fëmijës së tyre. T’ia zënë kohën me aktivitete, kulturë, sport.

Indiferencë që po na vret në 33 vite. Një indiferencë për të thënë të vërtetën e

sytë e pafajshëm dhe plot jetë të Martinit duhet të na tronditin të gjithëve. Të mos na lënë të flemë gjumë të qetë. Të reflektojmë thellë.

Sot duhet të jemi të gjithë, nëna, babai, motra, vëllai i Martinit. Nëse këtë se bëjmë me urgjencë, nesër do të jetë shumë vonë.

Mbrojtja e fëmijëve është emergjencë kombëtare!





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Divizionet shqiptare në ndjekje të armikut

Tërheqja e Korpusit XXI gjerman nga drejtimi Podgoricë-Kolashin-Prijepolje-Vishegrad-Sarajevë doli më i vështirë sesa pritej. Njësia u pengua nga koha e keqe me shi e dëborë, nga fryrja e lumenjve dhe nga urat e prishura. Pengesa kryesore u shkaktua nga goditjet e vazhdueshme të njësive të UNÇSH-së, gjë që komanda gjermane nuk e kishte llogaritur. Me çlirimin e Shqipërisë, me kërkesën e Komandës së Përgjithshme të UNÇSH-së dhe me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm, Divizionet V-VI të UNÇSH-së vazhduan ndjekjen e trupave hitleriane në tokën Jugosllave. Kryerja e operacioneve të njësive të UNÇSH-së në ndjekje të ushtrisë pushtuese gjermane përtej kufijve shtetërorë, në Jugosllavi, ishte e parashikuar në planin strategjik të Shtabit të Përgjithshëm në maj 1944. Veç detyrës themelore për çlirimin e atdheut, në Kongresin e Përmetit, iu dha urdhër ushtrisë të hidhej përtej kufirit në ndihmë të popujve vëllezër të Jugosllavisë për çlirimin e tyre. Ide që u konkretizuan me çlirimin e plotë të atdheut. Ndjekja e trupave gjermane në Jugosllavi në nëntor të vitit 1944 u parashikua të kryhej në dy drejtime operative. DVIS do të kryente operacionin mësymës kundër armikut që mbrohej në krahinat e Malit të Zi, ndërsa DVS në krahinat e Sanxhakut. Realizimi i detyrave luftarake dhe dalja në kohë në vijat e caktuara ndikoi në kryerjen me sukses të operacioneve të divizioneve të UNÇSH-së në Bosnjën Jugore. Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së, në planin e saj operativ kishte parashikuar ndjekjen e forcave të ushtrisë gjermane nga Shkodra në drejtim të Malit të Zi. Më vonë doli çështja e marshimit drejt veriut, Senicë-Vishegrad në Jugosllavi dhe e njësive të UNÇSH-së që çliruan Kosovën. Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së pranoi të kryhej ky veprim, sepse në planin e saj strategjik parashikohej lufta me pushtuesit gjermanë dhe përtej kufijve shtetërorë, madje ndjekja e armiqve derisa të merrej lidhje me Ushtrinë e Kuqe. Më 22 nëntor 1944, kur zhvillohej operacioni për çlirimin e Shkodrës, Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së urdhëronte, që porsa të jetë çliruar Shkodra, dy brigada të DVIS të marshojnë në drejtimin Podgoricë-Danilovgrad dhe në bashkëpunim me forcat jugosllave të godasin armikun. DVS të marshojë në drejtim të Mitrovicës duke goditur armikun dhe të marrë kontakt me forcat jugosllave dhe me Ushtrinë e Kuqe. Urdhër ky, që i gjeti në Kosovë brigadat e DVS ndërsa forcat e DVIS morën pjesë në çlirimin e Shkodrës.

DVS dhe DVIS vareshin drejtpërdrejt nga Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së, por kishin lidhje me shtabin e Korpmatës III, me qendër në Shkodër. Në pikëpamje operative dhe të furnizimit me municione, ushqime, veshmbathje etj., divizionet shqiptare do bashkëvepronin dhe me njësitë e UNÇ-së Jugosllave. Më 29 nëntor, shtabi i Korpmatës III mori urdhër nga Komandanti i Përgjithshëm, për ndjekje të ushtrisë gjermane në Mal të Zi të shkonte i gjithë DVIS në përbërje të të cilit ishin BrVIS, BrVIIS e BrXXIIS. Ndërsa më 4 dhjetor 1944, këtij divizionit iu shtua dhe BrVIIS, të cilës ju ngarkua detyrë të kalonte menjëherë për veprime luftarake në Mal të Zi. Pas marrjes së urdhrit, për të kaluar në ndjekje të armikut përtej kufijve shtetërorë, komandat dhe shtabet e divizione, bënë një punë të gjithanshme sqaruese e bindëse, për kuptimin politik e ushtarak të detyrës së marrë, si dhe për mobilizimin e gjithë efektivit në kryerjen me fitore të kësaj detyre të madhe internacionaliste. Për këtë qëllim në brigada e batalione u zhvilluan mbledhje e konferenca, u bë punë sqaruese me gjithë partizanët për të njohur e kuptuar detyrën, për të krijuar bindje jo vetëm në mundësinë e kryerjes së saj, por edhe të vendosmërisë që kërkohej për të mposhtur vështirësitë që ishin përpara. Këtë detyrë luftarake gjithë efektiv i DVS dhe DVIS e pritën me krenari dhe u treguan të gatshëm e të ndërgjegjshëm për ta kryer me nder e burrëri kundër armikut dhe për t'u kthyer fitimtarë në atdhe, në Shqipëri.

Veprimet luftarake të DVIS të UNÇSH-së për çlirimin e Malit të Zi

Në mesditën e datës 29 nëntor, batalionet e BrVIS kaluan të parat kufirin shtetëror në Hot e në Grudë. Detyra e parë e caktuar ishte shkatërrimi i pikëmbështetjeve gjermane në Medun e Bioçe. Të nesërmen doli në Mal të Zi edhe BrXXIIS (me tre batalione), që u ngarkua të sulmonte armiqet drejt Tuzit. Dy batalione të BrVIIS hynë në Mal të Zi pas BrVIS dhe BrXXIIS dhe u përqendruan afër kufirit shtetëror në pritje të ardhjes së forcave të tjera që ishin duke spastruar krahinën e Dukagjinit nga mbeturinat e reaksionit. BrVIIS do të kapërcente kufirin, më 8 dhjetor, për t'u bashkuar me brigadat e tjera të DVIS. Ditët e para të dhjetorit BrVIS zhvilloi luftime me armiqet në verilindje të Podgoricës, ndërsa BrXXIIS në drejtim të Tuzit, në Bozhaj e në Deçiq në juglindje të Podgoricës. Në Medun, në Bioçe e në Deçiq luftimet ishin të përgjakshme. Për Deçiçin e Bioçen u zhvilluan luftime të tjera të rrepta, kurse pikëmbështetjen gjermane në Medun luftëtarët e UNÇSH-së e shkatërruan, duke i hequr armikut nga duart një nga pikat e rëndësishme për mbrojtjen e Podgoricës. Veprimet luftarake që zhvilluan të dy brigadat luajtën rol të rëndësishëm për fillimin dhe vazhdimin e mëtejshëm të operacionit mësymës të DVIS të UNÇSH-së në Mal të Zi. Armikut iu zbulua e gjithë vija e parë e mbrojtjes dhe pozicionet e tjera më në thellësi, iu shkaktuan

Divizionet V-VI të Ushtrisë Shqiptare, në luftime jashtë kufijve shtetëror



dëme në njerëz e armatime. Të gjitha këto e rraskapitën armikun, megjithëse ishin në pozicione të përgatitura. Forcat partizane pas luftimesh të ashpra, më 2 dhjetor 1944, çliruan Tuzin dhe në gjysmën e dytë të muajit dhjetor, Podgoricën.

Forcat e DVIS u hodhën në mësymje kundër trupave armike të Divizionit 81, dhe pjesërisht të Divizionit 22 granatier, nga vija që shtrihej në të djathtë të lumit Lin, në drejtim të rrugës Dobrunjë-Vishegrad, në krahun e majtë të Çaçiqit, Drinskos, Poljaniçit, Suagorës. etj. Luftimet në këtë drejtim e detyruan armikun të tërhiqej nga Dobrunji dhe të vendosej në pozicionet e fortifikuara të Vishegradit, i ndjekur këmba-këmbës nga forcat partizane, të cilat përparonin me guxim, dhe u përhapën për t'u rreshtuar në frontin e Vishegradit. Lufta për çlirimin e Vishegradit ka qenë nga më të përgjakshmet.

Veprimet luftarake të DVS të UNÇSH-së për çlirimin Kosovës dhe të Sanxhakut

DVS ka zhvilluar luftime të ashpra për çlirimin e Kosovës dhe për të ndihmuar fuqimisht forcat partizane jugosllave në çlirimin e Sanxhakut nga pushtuesit fashistë. Në përbërje të këtij divizioni ishin rreshtuan BrIIS, BrVS, BrXXVS. Më 13 tetor 1944, forcat partizane të BrIIS e BrVS urdhërohen nga Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë, për të kaluar kufirin shtetëror të Shqipërisë dhe të vazhdonin të luftonin kundër trupave naziste për çlirimin e Kosovës. Më 8 dhjetor 1944, shtabi i divizionit, që ndodhej në Prishtinë, mori urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, që forcat e tij të lëvizin në drejtim të Senicës dhe në bashkëpunim me forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave të ndiqnin forcat armike që ishin në zonë.

Përparimi i forcave të DVS në drejtim të Prijepoljes, për të dalë në rrethinat e Pribojit dhe të Vishegradit, e ndante frontin e trupave gjermane në dy pjesë duke i vënë ato në kushte rrethimi dhe asgjësimi. Për arrijtjen e këtij qëllimi marshimi u krye në drejtimin Mitrovicë-Novi-Pazar-Senicë. BrIIS lëvizi në rrugëkalimin Serbicë-Istoku i Madh-Tutinë-Senicë; BrVS në rrugëkalimin Mitrovicë-Novi-Pazar-Senicë; BrXXVS, me mbërritjen nga Ferizaj në Mitrovicë, marshoi në rrugëkalimin e BrIIS. Lëvizja e forcave partizane në këto rrugëkalime u krye në kushte mjaft të vështira të dimrit të ashpër dhe të terrenit malor që i kalonte 1000 m. Vështirësitë shtoheshin dhe më shumë nga mungesa e ushqimit dhe veshmbathja e papërshtatshme që kishin partizanët. Me mbritjen e brigadave të UNÇSH në rajonet e caktuara trupat gjermane e kishin lëshuar Senicën dhe ishin afër Prijepoljes dhe rrugës Prijepolje-Priboj-Vishegrad. Shtabi i divizionit, në përshtatje me gjendjen, u caktoi BrIIS dhe BrVS, të sulmonin në drejtim të rrugës Senicë-Prijepolje, e para nga ana jugore, e dyta nga ana veriore, për t'i rrethuar e veçuar trupat armike duke u prerë rrugën me Prijepoljen dhe të sulmonin për çlirimin e qytetit. BrXXVS do hynte në veprim pas udhëzimesh të tjera. Ndërkohë shtabi i DVS u zhvendos nga Novi-Pazari në Senicë. Më 18 dhjetor forcat e BrIIS dhe BrVS, u afruan për të zënë vijat e sulmit, por armiku i zbuloi veprimet e forcave partizane. Në orët e para të mëngjesit të 19 dhjetorit një batalion i BrVS u sulmua nga një batalion hitlerianësh, afër fshatit Halinoviç, në veriperëndim të Senicës dhe papritur u gjend i rrethuar dhe ishte pothuaj në asgjësim. Por, duke ruajtur gjakftohësinë, komanda e batalionit dhe partizanët mundën të çanin rrethimin dhe më 21 dhjetor, së bashku me një batalion tjetër i sulmuan ushtarët hitlerianë, i thyen ata dhe i ndoqën deri afër Miloshevos, 15 km në juglindje të Prijepoljes. Në këto ditë BrIIS goditi trupat gjermane të përqendruara në Kashevo, 10 km në juglindje të Prijepoljes. Një batalion i saj i dëboi armiqet nga të pesë lagjet e qendrës së banuar dhe iu afrua rrugës që lidh Prijepoljen me Malin e Zi. Duke u futur si pykë në pozicionet e gjermanëve forcat e këtij batalioni hapën zjarr dhe u shkaktonin humbje forcave armike që vazhdonin tërheqjen nga Mali i Zi. Ndërkohë një batalion tjetër sulmoi pikëmbështetjen armike në Gorne-Gonja, 12 km në veriperëndim të Senicës, duke e shtrënguar armikun të lëshonte një pjesë të pozicioneve. Të nesërmen, sulmi u përsërit dhe vazhdoi derisa ushtarët gjermanë e braktisën pikëmbështetjen e Gorne-Gonjës mbi rrugën Senicë-Prijepolje. Luftimet e zhvilluara

më 19-21 dhjetor e humbën befasinë e mësymjes në shkallë operative, megjithatë repartet dhe njësitë e DVS arritën të zbulojnë të gjithë vijën e parë të mbrojtjes së armikut e të zinin pozicione të përshtatshme për të vazhduar veprimet e mëtejshme luftarake. Prej 22 dhjetorit u zhvilluan sulme të bashkërenduara të BrIIS e BrVS kundër pikëmbështetjeve gjermane në të dyja anët e rrugës Senicë-Prijepolje, prej Gome-Gonjës në Kashevo etj.

Më 24 dhjetor forcat e BrIIS e BrVS kaluan në sulm të fuqishëm në të gjithë frontin. Përparimi i BrVS dhe marrja e lartësisë së Bitovnikut prej një batalionit të saj bëri mbylljen e tërheqjes së trupave gjermane në drejtimin Prijepolje-Priboj-Vishegrad. Gjendja për armikun u bë më kritike kur një batalion i BrIIS doli në afërsi të rrugës Senicë-Prijepolje. Me këtë u krijua një front i pashkëputur midis brigadave. Pas kësaj forcat e divizionit përparuan rreth 2-3 km dhe kapën disa pikëmbështetje kyç në mbrojtjen e armikut. Duke vazhduar mësymjen armiku u detyrua të tërhiqet edhe 3-4 km të tjera dhe zuri vijën e përforcuar gjatë sistemit malor të luginës së lumit Lim. Përparimi i forcave me krahët e brendshëm të të dyja brigadave rrezikonte ndarjen në dy pjesë të mbrojtjes së armikut, rrethimin dhe asgjësimin e tij. Këtu përfundon dhe faza e parë e veprimeve të DVS në Sanxhak. Në fazën e dytë luftimet e DVS do të zhvilloheshin në pesëmbëdhjetëditëshin e parë të janarit 1945 për çlirimin e qytetit të Prijepoljes, qendër e rëndësishme e krahinës, nyjë-kyç në rrugën e tërheqjes së trupave gjermane nga Mali i Zi. Vendin e BrIIS në këtë fazë e zuri BrXXVS. BrIIS kaloi në vijën e dytë, me qëllim që të ripërtërinte forcat. Në radhët e saj kishte filluar të përhapej me shpejtësi tifoja e morrit. Kjo sëmundje u bë rrezik i madh për divizionin. Të gjitha brigadat e divizionit kishin të sëmurë nga tifoja, por BrIIS kishte më shumë. Për të luftuar sëmundjen dhe për t'u përgatitur për veprime të reja luftarake, shtabi i DVS e zhvendosi atë në Senicë. Në ditët e para të janarit 1945 të dyja brigadat kryen pothuajse çdo ditë sulme kundër pikëmbështetjeve gjermane nga Kashevoja, Izovçiku për në Prijepolje dhe nga Prijepolja kundër pikëmbështetjeve dominuese në malin e Bitovnikut, duke e përmbledhur më tej armikun përqark Prijepoljes. BrXXVS doli në rrugën që lidh Prijepoljen me Malin e Zi, në luginën e lumit Lim, në juglindje të qytetit, dhe goditi pikëmbështetjet që mbronin këtë rrugë në Sopotnicë e Vodicë.

Më 10 janar dy brigadat e UNÇSH-së dhe forca të Divizionit XXXVII të UNÇJ u hodhën në mësymje të përgjithshme mbi armiqet në Prijepolje. Pas luftimesh të ashpra armiku u thye dhe natën e 10-11 janarit u tërhoq krejt nga qyteti, duke lënë dhjetëra të vvarë dhe material të shumtë luftarak. Në mëngjes në Prijepolje hynë partizanët. Ndërkaq BrVS e ndoqi armikun në tërheqje drejt Vishegradit. Të nesërmen, më 12 janar, ajo çliroi qytetin e vogël Priboj, 25 km nga Prijepolja. Luftimet për çlirimin e Prijepoljes e të Pribojit ishin veprimet e fundit të DVS kundër trupave pushtuese gjermane në Jugosllavi. Më 14 shkurt 1945 forcat e DVIS hynë në Vishegrad. Qyteti u çlirua. Me kryerjen me sukses të detyrës, forcat e të dy divizioneve u kthyen në Atdhe të mbuluara me lavdinë e fitores.

Sakrificat e mëdha që bënë partizanët shqiptar, krahas partizanëve jugosllavë, i bënë në emër të vëllazërimit dhe të ndihmës për luftë kundër fashizmit, në kuadrin e Luftës së Dytë Botërore. Ndaj dhe kujtimi i 350 dëshmorëve që dhanë jetën në luftën e përbashkët për çlirimin e popujve të Jugosllavisë, do të mbetet i paharruar për popujt. Luftën legjendare që bënë divizionet shqiptare në tokat e Jugosllavisë dhe gjakun që derdhën partizanët shqiptarë, nuk do të mundin ta mohojnë dhe errësojnë, demagogjia e historianëve serb, as shtrembërimet pa baza që i bëjnë kësaj lufte disa pseudo historianë. Populli dhe FA-të gjithmonë e përkujtojnë me krenari luftën e të dy divizioneve tona në tokat e Jugosllavisë. Këto veprime luftarake dhe kjo ndihmë nga luftëtarët shqiptarë kanë zënë vend në faqet e historisë së popullit shqiptarë dhe të popujve përparimtarë të botës, të cilët bashkëpunuan dhe luftuan kundër forcave fashiste të kohës, ashtu si dhe sot në luftën kundër forcave regresive e që duan të prishin qetësinë dhe paqen botërore.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Shumë njerëz në Siri po festojnë një kthesë politike mahnitëse dhe ngjarje që e kapi botën në befasi. Por ndryshimi i pushtetit është i mbuluar nga pasiguria. Është e paqartë se si do të jetë një sistem i ri qeverisës në Siri, si do të funksionojë, duke pasur parasysh grupet dhe interesat e ndryshme fituese të përfshira, dhe nëse riorganizimi i pushtetit do të çojë në një demokraci apo në paqëndrueshmëri të mëtejshme. Mbrojtja e Assadit ndaj opozitës së vendit ishte përforcuar nga aleatët e tij. Ndërsa forcat anti-qeveritare u rritën pas Pranverës Arabe të vitit 2011, Garda Revolucionare e Iranit si dhe përfaqësuesi i saj libanez Hezbollah ndihmuan në luftimin e grupeve të armatosura rebele në terren. Forcat Ajrore Siriane u përforcuan nga avionët luftarakë rusë. Jolani shprehu dëshirën që forcat e huaja të largohen nga Siria.

Konflikti në Siri kishte mbetur kryesisht i fjetur gjatë viteve të fundit, i përcaktuar si përleshje e nivelit të ulët midis rebelëve dhe regjimit të Assadit dhe jo ndryshime dramatike në territor dhe kontroll. Por më pas rebelët shfrytëzuan një mundësi, duke përfituar nga një qeveri e dobësuar, aleatët kryesorë të së cilës janë shumë më të preokupuar me konflikte të tjera. Lufta e Rusisë në Ukrainë, që nga viti 2022 i ka thithur asaj burime njerëzore dhe financiare. Nuk është më viti 2014, kur Moska ndërhyri për të shpëtuar Assadin, përparësitë e presidentit rus Vladimir Putin dhe shumica e avionëve, trupave dhe mercenarëve të tij janë në Ukrainë.

Irani ndërkohë është i angazhuar nga lufta e tij me Izraelin, e cila është përshkallëzuar në mënyrë dramatike vitin e kaluar. Përfaqësuesi kryesor i tij proxy Hezbollah, gjithashtu i erdhi në ndihmë Assadit në të kaluarën, është i shkatërruar nga sulmet ajrore izraelite. Rebelët e përdorën atë boshllëk për të avancuar në Siri dhe llogaritja e tyre ishte e saktë, duke përfunduar me një marshim drejt kryeqytetit që ndesh pak rezistencë. Koalicioni kundër regjimit tani po e shpërndan ushtrinë e Assadit, duke paraqitur vizionin e tij për një Siri pas Assadit. Irani ka shpenzuar miliarda dollarë për ta mbajtur Assadin në pushtet dhe ka pak të ngjarë që të heqë dorë nga ky investim.

Që kur shpërtheu nga baza e tyre në veriperëndim të Sirisë më shumë se një javë më parë, përparimi i rebelëve ka qenë jashtëzakonisht i shpejtë, duke marrë nën kontroll qytetin e dytë më të madh të vendit, Aleppo, përpara se të pushtonin qytetin strategjik të Hamës. Ofensiva shokuese i dha një goditje të madhe Assadit dhe mbështetësve të tij në Iran dhe Rusi, ndërsa rindezi një luftë civile që kishte qenë kryesisht e fjetur për vite me radhë.

Forcat opozitare të Sirisë janë të decentralizuara dhe të përbëra nga ideologji të ndryshme, megjithëse të bashkuara nga një qëllim i përbashkët për të përmbysur regjimin e Asadit. HTS është vetëm një nga grupet e shumta të armatosura që operojnë në Siri. Grupe të tjera që kontrollojnë territorin në vend përfshijnë Ushtrinë Kombëtare Siriane të mbështetur nga Turqia dhe Forcat Demokratike Siriane të udhëhequra nga kurdët, elementë të të cilave Turqia i sheh si një organizatë terroriste. Por rrënjët e HTS dhe Jolanit në lëvizjet ekstremiste islamike hedhin hije mbi planet dhe ambiciet e tij. Brenda territorit të kontrolluar nga rebelët në Siri, duket e qartë se Joani vepron më pak si një njeri i kërkuar dhe më shumë si një politikan. Pasi forcat besnike të tij morën kontrollin e Alepos, ai bëri një paraqitje publike në kështjellën historike të qytetit. Jolani thotë se ka kaluar nëpër episode transformimesh ndër vite. “Një person në të njëzetat e tyre do të ketë një personalitet të ndryshëm nga dikush në të tridhjetat ose të dyzetat, dhe sigurisht dikush në të pesëdhjetat. Kjo është natyra njerëzore”, justifikohet ai.

Hayat Tahrir al-Sham është vetëm një pjesë e këtij dialogu dhe ai mund të shpërbëhet në çdo kohë. Shtetet e Bashkuara, Turqia, Kombet e Bashkuara dhe disa vende të tjera perëndimore vazhdojnë të përcaktojnë HTS si një organizatë terroriste dhe SHBA-ja ka vendosur një shpërbllim prej 10 milionë dollarësh për Jolanin. Në një intervistë ekskluzive me CNN, Jolani nuk la asnjë dyshim se

Siria e çliruar nga Assad, apo e pushtuar nga Hayat Tahrir al-Sham?



KONFLIKTI NË SIRI KISHTË MBETUR KRYESISHT I FJETUR GJATË VITEVE TË FUNDIT, I PËRCAKTUAR SI PËRLESHJE E NIVELIT TË ULËT MIDIS REBELËVE DHE REGJIMIT TË ASSADIT DHE JO NDRYSHIME DRAMATIKE NË TERRITOR DHE KONTROLL. POR MË PAS REBELËT SHFRYTËZUAN NJË MUNDËSI, DUKE PËRFITUAR NGA NJË QEVERI E DOBËSUAR, ALEATËT KRYESORË TË SË CILËS JANË SHUMË MË TË PREOKUPUAR ME KONFLIKTE TË TJERA. LUFTA E RUSISË NË UKRAINË, QË NGA VITI 2022 I KA THITHUR ASAJ BURIME NJERËZORE DHE FINANCIARE.

ambiciet e Hayat Tahrir Al-Sham (HTS) është një grup që u formua nga një ish-degë e Al Kaedës dhe ka qëllim t'i japë fund regjimit të Assadit. Pas kthimit në atdheun e tij gjatë luftës civile siriane, ai drejtoi degën e grupit terrorist në Siri, kur ishte nën emrin Jabhat Al Nusra. Ai do të vazhdonte të ndërpriste lidhjet me Al Kaedën dhe organizata e tij u transformua në Hayat Tahrir Al-Sham, e njohur gjithashtu si Organizata për Çlirimin e Levantit, në fillim

të vitit 2017. HTS-ja, që është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara më 2018, ka ndërmjet 5.000 deri në 10.000 luftëtarë. Në intervistën e tij të parë në media pas vitesh, ai foli për planet për të krijuar një qeveri të bazuar në institucione dhe një “këshill të zgjedhur nga populli”.

Dikur aleat me Al Kaedën dhe nxënës i liderit të ardhshëm të ISIS-it, Abu Bakr al-Baghdadi, ai ka kërkuar të distancojë forcat



e tij nga islamizmi radikal që ndoqën ish-aleatët e tij. Ai njoftoi një ndarje nga Al Kaeda në vitin 2016 për të krijuar atë që ai tha se ishte një front kundër regjimit në Siri me fraksione të tjera lokale, të quajtur Jabhat. Fateh al-Sham (Fronti për Pushtimin e Levantit), i cili më vonë ndryshoi në Hayat Tahrir Al Sham (HTS), ose Organizata për Çlirimin e Levantit. HTS kishte qenë sundimtari de fakto i Idlibit, qyteti veriperëndimor sirian nga i cili filloi ofensiva e fundit.

Jolani dëshiron të duket si politikani i besueshëm për të drejtuar vendin, ka bërë përpjekje për të qetësuar sirianët e krishterë dhe kurdët, ndërsa ofensiva e tij u përhap në të gjithë vendin. Jolani i përshpejtoi përpjekjet e tij shumëvjeçare për të ripërcaktuar veten si një “burrë shteti”. Ai ka dhënë intervista për organizatat perëndimore të lajmeve, duke i thënë CNN-it se opozita e tij ka në plan të formojë një qeveri të përcaktuar nga institucionet dhe një “këshill të zgjedhur nga populli”. Analistët vënë në dukje se HTS ka një histori trajtimi mizor kundër armiqve politikë dhe është një pikëpyetje e hapur nëse shtrirja e tij do të vazhdojë meqë bota i ka sytë diku tjetër. Ai bën paralele me talebanët, kthimi i shpejtë i të cilëve në pushtet në Afganistan në vitin 2021 u shoqërua me një zhvendosje miqësore perëndimore për t’u dukur i moderuar, largpamës edhe pse talebanët zbatuan kthim në ligjin e Sheriatit dhe goditje ndaj të drejtave të grave dhe të pakicave.

Jolani projekttoi një vizion ndryshe për vendin e shkatërruar nga lufta dhe, ai përdori gjithashtu publikisht emrin e tij të vërtetë për herë të parë, Ahmed al- Sharaa, në vend të pseudonimit të luftës me të cilin ai njihet gjerësisht. Ndërsa përparimet ushtarake të koalicionit rebel zgjerojnë territorin dhe popullsinë nën kontrollin e tyre, Jolani këmbëngul se civilët nuk kishin asgjë për t’u frikësuar në menaxhimin e zonave të kontrolluara nga rebelët në Siri. “Njerëzit që i frikësohen qeverisjes islame ose kanë parë zbatime të pasakta të tij ose nuk e kuptojnë siç duhet”, deklaroi ai politikisht korrekt, pa mohuar natyrën islame të shtetit të ri.

Grupi po siguron civilët dhe grupet që pësuan persekutim nga duart e grupeve ekstremiste dhe xhihadiste në luftën civile dhjetëvjeçare të Sirisë. Ai thotë gjithashtu se ka bërë gjithçka për t’u thënë publikisht të krishterëve dhe pakicave të tjera fetare dhe etnike se ata do të jetojnë të sigurt nën sundimin e saj. Grupet e të drejtave të njeriut dhe monitoruesit lokalë megjithatë kanë ngritur alarmin për trajtimin më të fundit të HTS ndaj disidentëve politikë në Idlib, duke pretenduar se grupi kreu masa të ashpra ndaj protestave, torturoi dhe abuzoi me disidentët. Jolani i tha CNN se incidentet e abuzimit në burgje “nuk ishin bërë nën urdhrat apo udhëzimet tona” dhe HTS i kishte hetuar tashmë përgjegjësit e përfshirë.

Jolani u distancua kundër emërtimit të qëndrueshëm terrorist të HTS, duke e quajtur “kryesisht politike dhe, në të njëjtën kohë,

të pasaktë”, duke argumentuar se disa praktika ekstreme islamike kishin “krijuar një ndarje” midis HTS dhe grupeve xhihadiste. Ai pretendoi se ishte kundër disa prej taktikave më brutale të përdorura nga grupet e tjera xhihadiste, të cilat çuan në ndërprerjen e lidhjeve të tij me ta. Ai gjithashtu pretendoi se ai kurrë nuk ishte i përfshirë personalisht në sulmet ndaj civilëve.

Inspektorët e armëve të OKB-së kthyen prova “të shumta dhe të padiskutueshme” të përdorimit të gazit nervor në Siri, tha të hënën Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-moon, duke i quajtur gjetjet “përtej dyshimit dhe përtej zbehjes”. Raporti prej 38 faqesh i inspektorëve u publikua pasi Ban informoi anëtarët e Këshillit të Sigurimit mbi përmbajtjen e tij. Ekipi gjeti atë që e quajti “prova të qarta dhe bindëse” se agjenti nervor sarin u shpërnda nga raketa tokë-tokë “në një shkallë relativisht të madhe” në periferi të kryeqytetit sirian Damask, më 21 gusht. Ekipi identifikoi dy lloje ose raketa që tha se ishin përdorur për të shpërndarë gazin dhe trajektoret e tyre, dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë thënë se ato armë nuk dihet se janë në duart e rebelëve që luftojnë kundër qeverisë së presidentit sirian Bashar al-Assad.

Assad është gjenerata e dytë e një dinastie familjare autokratike që mbajti pushtetin në Siri për më shumë se pesë dekada. Ka studiuar në Londër, dhe e mori pushtetin në një zgjedhje të pakundërshtueshme pas vdekjes së babait të tij Hafez al-Assad, i cili kishte udhëhequr Partinë Baath që kur mori pushtetin në

IZRAELI DO TË MIRËPRESË HUMBJEN E PAPRITUR TË NDIKIMIT TË IRANIT NË SIRI. POR FORCAT E NETANYAHUT, NË TË NJËJTËN KOHË, KANË LËVIZUR TASHMË PËR TË FORCUAR KUFIRIN E VENDIT ME SIRINË, NJË REFLEKTIM I FRIKËS QË MBËSHTET NGJARJET E DITËVE TË FUNDIT. NË RUSI, PUTIN DO TË KUJDESET GJITHASHTU PËR EFEKTET E RËNIES SË ASSADIT NGA PUSHTETI. KA EFekte TË DUKSHME USHTARAKE PASI RUSIA PËRDORI DY BAZA NË SIRI PËR TË PROJEKTUAR FORCËN NË LINDJEN E MESME, SI DHE PASOJA TË MUNDSHME PËR UKRAINËN.

1970. Ashtu si babai i tij, gjatë gjithë luftës civile 13-vjeçare, janë akuzuar për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe sulme brutale kundër civilëve, me raporte për përdorimin e urisë si armë lufte, zhdukje me forcë dhe vrasje.

Ndër mizoritë më të rënda të Assadit ishte sulmi me gaz sarin i vitit 2013 në qytetin Ghouta, i cili vrau më shumë se 1,400 njerëz dhe u etiketua një krim lufte nga sekretari i përgjithshëm i atëhershëm i OKB-së. Objektet famëkeqe të paraburgimit të Assadit ishin vrma të zeza ku çdokush që konsiderohej kundërshtar i regjimit zhdukej, me raporte të përhapura për tortura dhe kushte çnjerëzore. Në vitin 2017, një raport i Amnesty International pretendonte se rreth 13,000 njerëz ishin varur nga viti 2011 deri në 2015 në burgun Saydnaya.

Por ekspertët pyesin nëse faza tjetër do të jetë një agim i ri për një popull të mbytur nga një autokraci brutale, apo nëse sektarizmi do të sjellë një lloj tjetër sundimi autoritar, aq më keq në një të ngjashëm me talebanët në Afganistan. Presidenti i SHBA-ve, Joe Biden e përshkroi rënien e regjimit të Assadit si një “mundësi historike për popullin e shumëvuahtur të Sirisë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë”, por paralajmëroi se ishte gjithashtu një moment rreziku dhe pasigurie në rajon dhe nuk tha asgjë për të ardhmen e “terroristit” Jolani.

Izraeli do të mirëpresë humbjen e papritur të ndikimit të Iranit në Siri. Por forcat e Netanyahu, në të njëjtën kohë, kanë lëvizur tashmë për të forcuar kufirin e vendit me Sirinë, një refleksim i frikës që mbështet ngjarjet e ditëve të fundit. Në Rusi, Putin do të kujdeset gjithashtu për efektet e rënies së Assadit nga pushteti. Ka efekte të dukshme ushtarake pasi Rusia përdori dy baza në Siri për të projektuar forcën në Lindjen e Mesme, si dhe pasoja të mundshme për Ukrainën. “Aventura ushtarake e Putinit në Siri ishte e dizajnuar të demonstronte se Rusia është fuqi e madhe dhe mund ta projektojë ndikimin e saj jashtë vendit”, tha Phillip Smyth, ekspert për Lindjen e Mesme. “Humbja e Sirisë është shuplakë e fortë në fytyrën e Putinit”. Megjithatë, dy bazat ushtarake ruse në Siri, aeroporti Khmeimim dhe porti i Tartusit, mbeten për t’u mbrojtur. Nëse, siç pretendojnë agjencitë ruse, kryengritësit nuk kanë garantuar vërtetë sigurinë e tyre, humbja e dy bazave do të përbënte një goditje serioze për ambiciet gjeopolitike të Putinit në Mesdhe dhe Afrikë.

Në Ballkan shtetet “vegla” të Putin besoj se do të zhgënjehen nga dobësimi i fuqisë së tij në Siri. Ne në Shqipëri, duke shpresuar për më të mirën duhet të përgatitemi edhe për më të keqen, pasi grupe ushtarake terroriste dhe me mercenarë mund të sfidojnë sigurinë e shteteve të ndryshme. Shenjat dhe sinjalet e fundit në Banjckë dhe në Zubin Patok tregojnë se këta grupe proxy ekzistojnë, financohen, mbështeten dhe “ushqehen” nga shtete dhe forca me qëllime të errëta.

SKËNDERBEGASI

Dhimitër Lala, mjeshtër i kinematografisë shqiptare

Ish-partizani e skënderbegasi Dhimitër Lala, që u ul në shkollën e kadetëve më 28 mars 1945, ditën e çeljes së saj, është një nga emrat e njohur të kinematografisë shqiptare. Dhimitër Lala u lind në qytetin e Pogradecit, më 2 tetor 1931. Fëmijërinë e shkollimin e kaloi në këtë qytet të bukur buzë liqenit. Kur në fshat erdhi brigada e IV Sulmuese, ai i bashkohet asaj dhe del partizan. Me këtë njësi partizane ai ka marrë pjesë në shumë beteja, përfshi dhe atë për çlirimin e Tiranës. Ai është një nga kadetët e parë që erdhën direkt nga Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare kadet në shkollën ushtarake “Skënderbej”, që ditën e parë të çeljes së saj, më 28 mars të vitit 1945. Ai ka qenë ndër skënderbegasit më të mirë në mësimet atë kohë, por që shfaqte dhe pasionin e dëshirën e madhe për artin. Në kujtesën e tij, shkolla “Skënderbej” mbetet institucioni kryesor që e përgatiti, mësoi e edukoi që të ecte përpara në karrierën ushtarake dhe më pas në rrugën e vështirë të artit.

Në vazhdim ai kreu dhe shkollën e lartë ushtarake, ku për disa vite punoi në strukturat ushtarake. Por në vitin 1953, ai largohet nga ushtria dhe nis punën në Kinostudion “Shqipëria e Re”. Artisti Dhimitër Lala ka bërë 25 filma dokumentarë e ka xhiruar shumë aktivitete brenda vendit dhe jashtë tij.

Artisti Dhimitër Lala, iu bashkua Lëvizjes Nacional Çlirimtare, ku luftoi deri në çlirimin e vendit. Për aftësi në luftë mori “Medaljen e Trimërisë”, “Medaljen e Çlirimit” dhe “Medaljen e Kujtimit”.

Pas lufte ndoqi shkollën “Skënderbej”, duke qenë një nga nxënësit e parë që erdhën nga lufta me armë mbi supe në shkollën ushtarake.

